




THE WORLD BANK

SHQIPËRIA: TRENDI I VARFËRISË 2002 - 2005-2008

A. RITJA EKONOMIKE DHE VARFËRIA

1.1 Një normë rritjeje e lartë e PBB-së, dhe rritja e pagave dhe pensioneve janë shoqëruar nga një reduktim i mëtejshëm i varfërisë. Pjesa e popullsisë, konsumi mujor real për frymë i të cilës është nën 4891 Lekë (me çmimet e 2002) ka rënë nga 25.4% në 2002 në 18.5% në 2005 dhe në 12.4% në 2008 (Figura 1 dhe Tabela 1). Kjo do të thotë se, rreth 200,000 nga 575,000 të varfër në 2005 kanë dalë nga varfëria. Popullsia ekstremisht e varfër, e përcaktuar si personat që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore, është ulur nga 5% në 2002 në 3.5% në 2005 në 1.2% në 2008 (Tabela A1). Në zonat urbane, vetëm 1.17% e popullsisë mund të konsiderohet si ekstremisht e varfër (Tabela A2).

Figura 1: Trendi i varfërisë absolute



1.2 Tregues të tjerë të varfërisë, gjithashtu kanë vazhduar të bien ndjeshëm. Dy treguesit e tjerë, alternativë përveç shkallës së varfërisë (përqindjes së të varfërve), janë hendeku i varfërisë dhe ashpërsia e varfërisë. Hendeku i varfërisë (nganjëherë referuar si thellësi e varfërisë) jep sesa larg janë familjet nga linja e varfërisë. Ky tregues përftohet nga raporti i shumës së diferencave të konsumit të të varfërve nga linja e varfërisë për të gjithë të varfërit ndaj totalit të popullsisë, duke e shprehur atë si përqindje të linjës së varfërisë. Kështu një hendek varfërie prej 2 përqind do të thotë se shumata totale që do t'i duhej të varfërve për të arritur nivelin e vijës së varfërisë është i barabartë me popullsinë shumëzuar me 2 përqind të kufirit të varfërisë. Avantazhi kryesor i hendekut të varfërisë është që kontributi individual i një të varfëri në të gjithë varfërinë është më e madhe sa më i varfër është individi. Treguesi i dytë alternativ është ashpërsia e varfërisë, përparësia kryesore e të cilit është ndjeshmëria e tij ndaj pabarazisë ndërmjet të varfërve. Ashpërsia e varfërisë merr parasysh jo vetëm distancën e të varfërve nga linja e varfërisë por edhe pabarazinë ndërmjet të varfërve. Kështu, të varfërit që janë më larg linjës së varfërisë kanë një peshë më të madhe. Figura 1 dhe Tabela 1 tregojnë që hendeku i varfërisë ka rënë nga 5.7% në 2002 në 4.0% në 2005 në 2.3% në 2008, ndërsa ashpërsia e varfërisë ka rënë nga 2% në 1.3% në 0.7% për të njëjtën periudhë.

Stratat	Matësit e varfërisë	2002			2005			2008		
		Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej
	Përqindja	20.2	20.9	20.6	11.6	19.7	16.2	10.7	15.0	13.0
Bregdetare	Hendeku	5.4	3.6	4.4	2.0	4.1	3.2	2.7	2.5	0.2
	Ashpërsia	2.1	1.0	1.5	0.6	1.3	1.0	1.0	0.6	0.7
	Përqindja	19.3	28.5	25.6	12.5	25.9	21.2	10.3	10.9	10.7
Qendër	Hendeku	3.8	6.5	5.7	3.0	6.0	5.0	1.9	1.9	1.9
	Ashpërsia	1.2	2.1	1.8	1.2	2.1	1.8	0.6	0.4	0.5
	Përqindja	24.7	49.5	44.5	17.1	27.7	25.6	14.7	29.8	26.6
Malore	Hendeku	6.5	12.3	11.1	3.6	5.5	5.1	3.2	6.2	5.6
	Ashpërsia	2.6	4.4	4.1	1.1	1.7	1.5	1.2	1.8	1.7
	Përqindja	17.8		17.8	8.1		8.1	8.7		8.7
Tirana	Hendeku	3.8		3.8	1.6		1.6	1.2		1.2
	Ashpërsia	1.3		1.3	0.5		0.5	0.2		0.2
	Përqindja	19.5	29.6	25.4	11.2	24.2	18.5	10.1	14.6	12.4
Gjithsej	Hendeku	4.5	6.6	5.7	2.3	5.3	4.0	1.9	2.6	2.3
	Ashpërsia	1.6	2.1	1.9	0.8	1.8	1.3	0.6	0.7	0.7


Tabela 1: Trendi i varfërisë absolute sipas stratave: 2002, 2005, 2008

1.3 Ulja e vazhdueshme e varfërisë është shoqëruar me zvogëlim të diferencës edhe përsa i përket varfërisë rajonale. Ndryshimet në normat e varfërisë midis rajoneve të përcaktuar si katër strata¹, janë zvogëluar në krahasim me vitin 2005, me përjashtim të zonave të rajonit malor (Figura 2). Për shembull, në zonat e rajonit Qendror, të cilat shfaqin uljen më të madhe të varfërisë, vetëm 10.7% e popullsisë është e varfër në krahasim me 21.2% në vitin 2005. Zonat e rajonit Bregdetar gjithashtu kanë përjetuar një rënie të konsiderueshme të varfërisë. Krahasuar me vitin 2005, përqindja e popullsisë së varfër është ulur nga 16.2% në 2005 në 13.0% në 2008. Ndryshe nga zonat Qendrore dhe Bregdetare, zona Malore ka mbetur prapa, duke e rritur diferencën me zonat e tjera. Tirana gjithashtu, megjithëse shfaq nivelin më të ulët të varfërisë midis rajoneve, nuk ka pasur reduktim të mëtejshëm në krahasim me 2005 (një rritje e vogël në 8.7% në 2008 nga 8.1% në 2005). Përqindja e të varfërve në zonat Malore tregojnë për një ndryshim pothuajse të papërfillshëm nga 25.6% në 2005 në 26.6% në 2008. Brenda rajonit

¹ Është e rëndësishme të merret parasysh se katër rajonet e përcaktuara në këtë mënyrë (shih Tabelën A3) nuk janë të njëjta me ato administrative të cilave iu referohemi si prefektura. Rajonet – strata, janë zona që janë grupuar së bashku sepse kanë ngjashmëri dhe afërsi gjeografike. Në fakt rajonet e përcaktuara për efekt të anketës janë katër, ndërsa prefekturat janë 12.

Malor, problemi shfaqet më ndjeshëm në zonat rurale. Varfëria rurale në të gjitha rajonet e tjera ka përjetuar rënie të ndjeshme në vitin 2008, megjithatë në rajonin Malor, varfëria rurale ka qëndruar pothuajse e njëjtë. Më saktësisht, ndërsa në rajonet rurale shkalla e varfërisë ishte 67% më e lartë se niveli kombëtar i zonave rurale në vitin 2002, dhe vetëm 14% më e lartë në vitin 2005, tani është 104% më e lartë (shih Tabelën 1). Nga ana tjetër, normat e varfërisë rurale për dy rajonet e tjera në 2008 janë pothuajse në nivelin e varfërisë kombëtare rurale ose ulen ndjeshëm nën të.

Figura 2: Trendi i varfërisë sipas rajoneve




1.4 Ulja e ndjeshme e varfërisë midis rajoneve u shoqërua me një rënie më të shpejtë të shkallës së varfërisë rurale. Tabela 2 tregon se ndërsa varfëria rurale ka rënë me rreth 47%, varfëria urbane u ul me 1.2%. Në këtë mënyrë, ndërsa shkalla e varfërisë në zonat rurale pësoi rënie nga 24.2% në 2005 në 14.6% në 2008, linja e varfërisë në zonat urbane ra nga 11.2% në 10.1%. Veç kësaj, edhe brenda zonave rurale, shkalla e reduktimit të varfërisë është dukshëm më e lartë në rajonin Qendror krahasuar me zonat rurale të rajoneve të tjera. Përkundër një reduktimi të ndjeshëm të varfërisë në zonat rurale në përgjithësi, të varfërit janë ende të përqendruar në zonat rurale të Rajonit Malor. Treguesit e tjerë të varfërisë në zonat rurale tregojnë gjithashtu një rënie më të madhe. Megjithëse, treguesi i hendekut (thellësia) të varfërisë për zonat rurale është 2.6% në vitin 2008, krahasuar me 1.9% në zonat urbane, për zonat rurale kjo është një ulje prej 51% nga niveli i vitit 2005, ndërkohë që për zonat urbane ka pasur një ulje prej 17%.

Tabela 2: Ndryshimet në përqindje të uljes së varfërisë në zonat urbane dhe rurale

	Varfëria sipas zonave			Ndryshimi në varfëri	
	2002	2005	2008	% e ndryshimit 2002-2005	% e ndryshimit 2005-2008
Popullsia në varfëri	813,196	575,659	373,137	-29.21	-35.2%
Urban	257,690	151,811	150,052	-41.09	-1.2%
Rural	555,506	423,848	223,085	-23.70	-47.4%

Figura 3: Ndryshimet në treguesit e varfërisë: urbane dhe rurale



1.5 Përqindja që zënë shpenzimet për arsim ndaj totalit të konsumit real për frymë shfaqin rritjen më të madhe që nga viti 2005 krahasuar me zërat e tjerë. Shpenzimet për arsim dhe përqindja e tij ndaj totalit në 2008, janë rritur përkatësisht me rreth 57% dhe 53% që nga viti 2005 (Tabela 3 dhe Tabela 4). Shpenzimet për frymë të konsumit për ushqim në terma realë në 2008 (llogaritur me çmimet e 2002) janë rritur nga 9,105 Lek në vitin 2005 në 9,731 Lek në vitin 2008 (Tabela 4). Ndërsa, konsideruar si përqindje ndaj totalit të konsumit për frymë, përqindja e konsumit për ushqim ka rënë me 2.3% në periudhën 2005-2008 (Tabela 3). Rritja në shpenzimet e arsimit dhe në përqindjen që zënë ndaj konsumit real për frymë në 2008 dhe ulja në shpenzimet për ushqim ndaj këtij totali tregojnë një cilësi më të lartë të nivelit të jetesës në Shqipëri. Parimisht, kur arrihen nivele të kënaqshme të konsumit, përqindja që i dedikohet ushqimit ndaj konsumit total pritet të shfaqë një tendencë rënieje, meqenëse kur individët arrijnë të kënaqin kërkesat ushqimore, i përdorin të ardhurat shtesë për veprimtari të tjera. Në 2008, kjo dukuri duket se është drejtuar ndaj investimeve më të larta në arsim. Në fakt, në periudhën 2005-2008, numri i nxënësve dhe studentëve ka pasur një rritje të ndjeshme në Shqipëri. Gjithashtu,

është verifikuar një rritje e konsiderueshme e shkollave private në vend, si dhe një rritje në numrin e studentëve që studiojnë jashtë vendit. Këta faktorë përputhen me rritjen e shpenzimeve për arsim si dhe të përqindjes që zë ai ndaj totalit të konsumit real për frymë.

Tabela 3: Përqindjet ndaj totalit të konsumit real për frymë

Komponentët e konsumit	2002	2005	2008
Për ushqim	64.5	59.2	57.9
Për konsum jo-ushqimor	19.4	24.8	22.8
Për nevoja bazë	12.6	12.6	15.2
Për arsim	2.3	2.4	3.7
Për pajisje afatgjata	1.2	0.9	0.5

Tabela 4: Përmbledhje e treguesve kryesorë

Treguesit	Mesatarja		
	2002	2005	2008
Konsumi total	7801	9105	9731
Për ushqim	4906	5159	5280
Për konsum jo-ushqimor	1655	2457	2519
Për arsim	177	275	432
Për nevoja bazë	958	1087	1447
Për pajisje afatgjata	105	128	56

-Vlerat mesatare janë paraqitur në Lekë të Reja.

B. KONKLUZIONE

1.6 Ky artikull analizon trendin e varfërisë në Shqipëri duke dhënë tre konkluzione kryesore. Së pari, analizon sesi një rritje mbresëlënëse prej 7.1% në vit e PBB-së reale në periudhën 1998-2008, së bashku me një rritje të pagave dhe pensione në 2005-2008, është shoqëruar dhe me një ulje të mëtejshme të varfërisë. Së dyti, ulja e ndjeshme në mënyrë të vazhdueshme e varfërisë është shoqëruar me ulje edhe më të ndjeshme në zonat rurale. Kjo ka ardhur si rrjedhim i uljeve drastike të varfërisë në zonat rurale të rajoneve Qendrore dhe Bregdetare. Së treti, megjithëse varfëria rurale ka rënë në mënyrë të ndjeshme, në zonën e rajonit Malor niveli i varfërisë nuk ka shfaqur ndryshime të rëndësishme. Të varfërit janë akoma të përqendruar në zonat rurale të rajonit Malor. Një hipotezë e mundshme që shpjegon këtë rezultat është krijimi i një kurthi të varfërisë në Rajonin Malor.

1.7 Roli i rëndësishëm i rritjes së qëndrueshme ekonomike si dhe i reformave ekonomike, që kanë çuar në qëndrueshmërinë makroekonomike, qeverisjen e përmirësuar, zhvillimin e investimeve në sektorin privat, përfitim të shërbimeve sociale publike (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale), si dhe infrastrukturën e zgjeruar duhet të vazhdojnë të mbahen në të njëjtat nivele në mënyrë që të mbahen të ulëta edhe nivelet e varfërisë. Njëkohësisht, duke i drejtuar përpjekjet në zgjidhjen e problemeve të rajonit Malor, do të arrihet një ulje më e shpejtë e varfërisë në të ardhmen.

C. SHTOJCË

Tabela A1: Trendi i Varfërisë Ekstreme sipas Rajoneve: 2002-2005-2008

Stratat	Matësit e varfërisë	2002			2005			2008		
		Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej
	Përqindja	5.9	1.8	3.6	1.8	2.5	2.2	1.9	1.0	1.4
Bregdetare	Hendeku	1.2	0.3	0.7	0.2	0.4	0.3	0.4	0.1	0.2
	Ashpërsia	0.3	0.1	0.2	0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1
	Përqindja	3.4	5.1	4.6	3.5	6	5.2	1.2	0.8	0.9
Qendër	Hendeku	0.5	0.5	0.5	0.8	0.9	0.9	0.3	0.1	0.2
	Ashpërsia	0.2	0.1	0.1	0.3	0.2	0.2	0.1	0.0	0.0
								0.0		0.0
	Përqindja	7.8	11.6	10.8	2.6	3.4	3.2	2.9	3.9	3.7
Malore	Hendeku	1.6	2.1	2	0.3	0.4	0.4	0.6	0.5	0.5
	Ashpërsia	0.5	0.5	0.5	0	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1
	Përqindja	2.3		2.3	1		1	0.2	0.0	0.2
Tirana	Hendeku	0.6		0.6	0.1		0.1	0.0	0.0	0.0
	Ashpërsia	0.2		0.2	0		0	0.0	0.0	0.0
	Përqindja	4.1	5.2	4.7	2.2	4.5	3.5	1.1	1.2	1.2
Gjithsej	Hendeku	0.8	0.7	0.8	0.4	0.7	0.5	0.2	0.2	0.2
	Ashpërsia	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0

Tabela A2: Trendi i varfërisë ekstreme sipas zonave urbane dhe rurale: 2002 -2005-2008

Zonat	Matësit e varfërisë	2002	2005	2008
Tirana	Përqindja	2.3	1.0	0.2
	Hendeku	0.6	0.1	0.0
	Ashpërsia	0.2	0.0	0.0
Tjera urbane	Përqindja	4.8	2.7	1.6
	Hendeku	0.9	0.5	0.4
	Ashpërsia	0.2	0.1	0.1
Rurale	Përqindja	5.2	4.5	1.2
	Hendeku	0.7	0.7	0.2
	Ashpërsia	0.2	0.1	0.0
Gjithsej	Përqindja	4.7	3.5	1.2
	Hendeku	0.8	0.5	0.2
	Ashpërsia	0.2	0.1	0.0

Tabela A3: Shpërndarja e rretheve sipas rajoneve

Rrethet sipas rajoneve			
Bregdetar	Qendër	Malor	(Tirana
Lezhë	Devoll	Kukës	Tirana urbane
Kurbin	Kolonjë	Has	Tirana te tjera urbane
Kavajë	Pogradec	Tropojë	
Mallakastër	Mirdite	Bulqizë	
Lushnjë	Puke	Dibër	
Delvine	Malësi e Madhe	Gramsh	
Sarande	Mat	Librazhd	
Durrës	Kuçove		
Fier	Skrapar		
Vlore	Krujë		
	Peqin		
	Gjirokastër		
	Përmet		
	Tepelenë		
	Shkodër		
	Elbasan		
	Berat		
	Korçë		
	Tirana (rural)		